

**V E N D I M**  
**Nr. 186, datë 21.4.2000**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.326, DATË 21.6.1993, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR KRITERET E TRAJTIMIT TË INVALIDËVE TË LUFTËS KUNDËR  
PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993, “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Paragrafi i dytë, pika 3, në vendimin nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:

“Këtë shtesë invalidi i luftës e merr edhe kur përfiton pension pleqërie. Kjo shtesë do t’u nënshtrohet të gjitha rritjeve që kanë pësuar dhe do të pësojnë pensionet për shkak të rritjes e të ndryshimit të çmimeve, duke filluar nga data 20 janar 1993.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi. Llogariten në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë dhe përballohen nga fondet e përcaktuara për shpërblimin e invalidëve dhe të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, në zërin “Financime”, në buxhetin e miratuar për vitin 2000 për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**